



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Himarë, më 22.10.2021

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike E-mail.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 18.10.2021 ardhur me postë elektronike, ku kërkohet informacion lidhur mbi ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në Bashkinë Himarë.

1. Sa është numri i inspektimeve të kryera në terren, lidhur me ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë gjatë në 2019;2020; 2021 (Deri tani)?
 - 2.Sa procesverbale janë mbajtur në përfundim të procesit vjetor të inspektimit (2019; 2020; 2021(Deri tani)?
 3. Sa është vlera totale në lekë e gjobave në secilin prej tri viteve në fjalë (2019; 2020; 2021 (Deri tani)?
 4. Sa raste të kapjes në flagrancë të ushtrimit të gjuetisë keni konstatuar në periudhën në fjalë dhe cilat kanë qënë konkretisht kafshët apo shpendët e vrarë (llojet dhe numri i tyre)?
 5. A keni ju, si Bashki, një listë totale të kafshëve (shpendë dhe karnivorë) të vrara, në 2019; 2020; 2021 (Deri tani)?
 6. Sa është numri inspektorëve që janë përgjegjës për ndalimin e gjuetisë dhe sa është sipërfaqja që duhet të mbikqyrë secili prej tyre? ,
- në mbështetje të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejten e informimit” , bashkëngjitur do të gjeni infomacionin e kërkuar.

Aktualisht, gjuetia në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji nr. 10253 datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, ndryshuar me ligjin nr. 43/2013, datë 14.2.2013.

Ligji i mësipërm përcakton me detaje mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të gjitha hallkave që lidhen me gjuetinë, gjuetarët dhe llojet e specieve që lejohen të gjuhen apo që edhe ndalohen.

Pushteti Lokal, konkretisht Bashkia në këtë ligj nuk është radhitur si institucion pjesëmarrës në këtë rregullim ligjor.

Bashkëlidhur, gjeni, ju lutem, ligjin nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, ndryshuar me ligjin nr. 43/2013, datë 14.2.2013.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!